



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Nr.09/7

Datë: 5.2.2025

THIRRJE PUBLIKE

Për Mbështetje Financiare Publike të Organizatave Jo-Qeveritare në Zbatimin dhe Promovimin e Aktiviteteve Kulturore dhe Rinore në Komunën e Shtimes

Në bazë të nenit 12 të Rregullorës MF Nr.04.2017 mbi kriteret, standardet, dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) e Komunës së Shtimes shpallë thirrje për të gjitha organizatat jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe individët, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës dhe rinisë, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zbatimin e aktiviteteve, zhvillimin, masovizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në Komunën e Shtimes .
2. OJQ-të dhe individët në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:
2.1.Të gjitha OJQ-të, Kulturore dhe Rinore në Komunën e Shtimes, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës dhe rinisë, si dhe të gjithë Individët që promovojnë kulturën, përmes të shkruarit, artit dhe shfaqjes.
3. Organizatat jo-qeveritare dhe individët mund të aplikojnë me një projekt që kontribuon në avancimin dhe fuqizimin e sektorit të kulturës dhe rinisë.
4. Vlera totale e planifikuar, e thirrjes është: **25,000.00 euro**
5. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune , nga data **5.2.2025** deri më datë **26.2.2025**
6. OJQ-të mund të aplikojnë me projekte në kuadër të kësaj thirrjeje, por vetëm me një projekt për fushën sipas thirrjes. Periudha e zbatimit projektit sipas thirrjes është deri në **dhjetor të vitit 2025**. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes publike.
6.1 Kriteret për aplikim
 - Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës .
 - OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e kulturës dhe rinisë.
 - OJQ-të duhet po ashtu të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofertuesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofertuesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

- Para nënshkrimit të kontratës OJQ duhet të paraqes prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së (Obligative, vetëm për OJQ)
- Certifikatën e numrit fiskal (Obligative, vetëm për OJQ)
- Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore, i cili duhet të dorëzohet komisionit vlerësues para publikimit të rezultateve përfundimtare (pas publikimit të rezultateve preliminare të përfituesve) (Obligative vetëm për OJQ).
- Të ketë dorëzuar projekt propozimin të plotësuar në formatin e aplikacionit sipas kërkesave të thirrjes publike (Obligative)
- Individ që janë banor të Komunës së Shtimes
- Individët aplikues duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e kulturës dhe rinisë.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilët së bashku me udhëzimet për aplikantë janë në dispozicion në uebfaqën e internetit të Komunes së Shtimes.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën: Rruga "Tahir Sinani" Nr.50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës /Zyra e Sportelit.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlersimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në zyrat e DKRS.



Drejtoresha, Albana Fazliu